



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

PRISHTINË - PRIŠTINA **TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.818/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, ne përbërje të Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Bejta Commerce”SHA-Gjilan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “Zuka Company” SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit tretë, pastrimi i lumenjve dhe largimi i deponive të egra” me nr. të prokurimit: 651-20-4015-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN, më datën: 13.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Bejta Commerce” SHA-Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit tretë, pastrimi i lumenjve dhe largimi i deponive të egra” me nr. të prokurimit: 651-20-4015-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: “Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit tretë, pastrimi i lumenjve dhe largimi i deponive të egra” me nr. të prokurimit: 651-20-4015-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Bejta Commerce” SHA-Gjilan, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “Bejta Commerce” SHA-Gjilan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 19.10.2020 me nr. 818/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit tretë, pastrimi i lumenjve dhe largimi i deponive të egra” me nr. të prokurimit: 651-20-4015-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-KUVENDI KOMUNAL-GJILAN, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 04.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankues “Bejta Commerce” SHA:

Pretendimi i OE ankuesit:

Me datë: 06.10.2020 ishim ne qasje ne zyret e prokurimit, prezent isha unë Musë Pireva nga kompania Bejta Commerce si dhe Izet Kurteshi-Drejtor i Prokurimit dhe zyrtarja Rezelina Uka -Zyrtare e prokurimit Gjilan.

Aty ne prezence bashkarishte vertetuam se pretendimet qe na jane dhene nuk qendrojne.

1. I kemi te vendosur 2 traktora dhe qe te dy jan sipas kerkeses edhe pse kerkesa ka qene 1 traktor.
- 2.1 kemi te vendosur 4 eskavator dhe qe te gjith jan sipas kerkeses se FDT.
- 3.1 kemi te vendosur 4 Cilindra dhe qe te gjith jan sipas kerksese se FDT.

Te gjitha këto janë te shënuar ne procesverbalin e mbajtur nga zyrtarja e prokurimit ne qasje ne dokumentacion gjithashtu si prove do ja bashkangjesim edhe ketë procesverbal ankesës.

Vlen te ceket se zyrtaret e prokurimit ne qasje edhe pse e vërtetuar bashkërisht nuk pranuan qe ta shënonin se është vërtetuar ne prezencën timen dhe te tyre por me gjithë kundërshtimin tim e shënuan ne procesverbal si pretendim timin.

Eksperti Shqyrtues sqaron, se AK ka shpallë të eliminuar ankuesin me arsyetimin:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

Komisioni gjatë vlersimit dhe ekzaminimit te ofertave duke u bazuar ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin per kontrat gjegjesisht te:

Kërkesa 4. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te D7 Si dhe Dëshmia 4. Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, C duhet te dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzimin.

Si përfundim, Komisioni Profesional për egzaminim dhe vlerësimin e Ofertave ka konstatuar se nuk e plotësoni kete Kriter ashtu siç eshte kerkuar ne DT si dhe ne Njoftimin per kontrate traktori nuk i plotëson kuhstet dhe specifikat e kerkuar, po ashtu disa eskavator ku nje prej tyre i mungon edhe nje cilindër.

Andaj sipas LPP dhe URPP oferta juaj shpallet e pa pergjegjeshme

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.


Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit


Eksperti Shqyrtues gjatë shqyrtimit të lëndës pretendimet e OE ankuesit i gjenë bazuara, me faktin se në ofertën e OE ankuesit gjenden këto paisje:

Kërkesa e AK-së:

Traktor me pesh 5-6 tone (fuqia max.90-100KW)	1
--	---

Ankuesi ka ofruar 2 traktor i cili e përmbushë kriterin:





 12.Traktor 5.1Ton.pdf

 12.Traktor Styer.pdf

Kërkesa e AK-së:

Eskavator 5 – 30 ton	4
----------------------	---





Në ofertën e ankuesit janë 4 eskavator të cilët e përmbushin kriterin:

-  6.Cat 325 cln 2004.pdf
-  6.Eskavator CAT 320 B.pdf
-  6.Eskavator CAT 325 CLN-05.pdf
-  6.Eskavator CAT 325 B.pdf

Kërkesa e AK-së :

Cilindër ngjeshës tamponi 3 deri 19 ton	4
--	----------

Në ofertën e ankuesit janë 4 Cilindër të cilët e përmbushin kriterin:

-  11.Bomag BW 213 -12Ton.pdf
-  11.Cilinder bomag 3 Ton.pdf
-  11.Cilinder Bomag 217-17.5 ton.pdf
-  11.Cilinder Bomag Puma 168.pdf

Eksperti Shqyrtues sqaron tutje, se AK ka shpallur ankuesin të eliminuar për kriteret e lartpërmendur, gjersa gjatë shqyrtimit të lëndës dhe verifikimit të ofertës në e-prokurim Eksperti shqyrtues ka vërejtur se këto kritere OE ankuesi i plotëson, dhe se mendon që është i përgjegjshëm por i pa suksesshëm me çmimin më të lartë.

Eksperti Shqyrtues po ashtu sqaron se OE ankuesi ka pretendime edhe lidhur me OE të rekomanduarin “Zuka Company” SHPK, i cili pretendon se ky i fundit nuk i plotëson kriteret e AK-së dhe se është i pa përgjegjshëm.

Pretendimi i OE ankuesit:

Sa i përket kompanisë që është shpallur si fituese e tenderit gjatë verifikimit të dokumenteve gjetëm këto mangësi:

-Te kërkesa e makinerisë pika 2. Kamion për pastrimin e rrugëve ka vendosur një kamion me targa 06-895-CT, që nuk ka regjistrim dhe që i ka skaduar në 2018.

Eksperti Shqyrtues gjatë shqyrtimit të lëndës dhe ofertës së OE të rekomanduarit në e-prokurim, pretendimin e lartpërmendur të OE ankuesit e gjene të pa bazuar, me faktin se në ofertën e të rekomanduarit janë të vendosur dy kamion për pastrimin e rrugëve, ashtu siç kërkohet në aneksin 7 në DT, ndërsa sa i përket targës 06-895-CT, nuk kemi gjet asnjë librezë me targën e faktuar nga OE ankuesi:


Kërkesa e AK-së:

Kamion për pastrim të rrugëve	2
--------------------------------------	----------

Eksperti Shqyrtues sqaron se në ofertën e OE të rekomanduarit ekzistojnë dhe në librezë shkrimi “Kamion për pastrimin e rrugëve me dy dyer”:

	
01/01/2017 01/01/2017	01/01/2017 01/01/2017
01/01/2017 01/01/2017	01/01/2017 01/01/2017
01/01/2017 01/01/2017	01/01/2017 01/01/2017

CRA/VB/VRC 1511619



CRA/VB/VRC 1511619


REPUBLIKA E SHqipërisë MINISTERI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS REPUBLIKAN E SHqipërisë
RKS QENDRORE BLESIMSHI DHE ALIUDHIMI VIKUMBAT PËNJA DHE TËRE VEHICILE REGJISTRUES VEHICULE
06-688-EE

CRA/VB/VRC 1511619

1
2
3
4
5
6
7
8
9
10

1
2
3
4
5
6
7
8
9
10

1
2
3
4
5
6
7
8
9
10

04.01.2018	26.10.2018
04.01.2018	06.07.2018



MINISTERI I BASHKËPUNIMIT
 DHE TË RREZESËS
 RKS
 QENDRISHKALLI KALIFORNIJE 1
 ALIBONDI 71
 STRADHATË PËRVEÇITIMORË NË GJERA
 VERE DËRËSHKALLI 41001
 TIRANË

06-848-CT

CRA/YPE/VRC 0809712

CRA/YPB/VRC 0809712

CRA/YPB/VRC 0809712

4	06-848-CT
1	06.07.2018
10.4	Trangull 200 g "Dorcas" 25x1
10.5	
10.6	
10.7	
10.8	
10.9	
10.10	
10.11	
10.12	

10.1	1000
10.2	2
10.3	
10.4	
10.5	1800
10.6	940
10.7	450

10.8	
10.9	
10.10	
10.11	
10.12	

Shprehja e përfunduar e rezultateve për
baza 2 Dytë

06.07.2018

Eksperti Shqyrtues sqaron, pretendimi i dytë i OE ankuesit lidhur me të rekomanduarin është si mposhtë:
 -Te kërkesa te pika 9. Ngarkues 10 deri ne 12 ton, ka vendosur një ngarkues qe nuk i plotëson kërkesat sepse pesha e ti është 14.5 ton.

Eksperti Shqyrtues sa i përket këtij pretendimi, gjatë shqyrtimit të ofertës së OE të rekomanduarit në e-prokurim, mendon se ky pretendim nuk gjendet i bazuar, me faktin se në kërkesën e AK-së tek aneksi 7

në DT kërkohet:

Ngarkues mbi 10 ton	1
---------------------	---

Eksperti tutje sqaron se, OE i rekomanduari ka përmbushur kriterin, sepse siç shihet kërkohet Ngarkues mbi 10 ton, dhe nuk ka limit DERI siç pretendon ankuesi 10 deri në 12 ton.


Eksperti Shqyrtues sqaron, pretendimi i tretë i OE ankuesit lidhur me të rekomanduarin është si më poshtë:

-Te kërkesa te pika 13. makineri ngjeshese prej 180-200kg, ka vendosur një foto te një makinerie te tillë dhe nuk ka asnjë dokument qe e vërteton qe makineria është prone e tina, përveç një flete qe e ka shkruar ne kompjuter vet dhe e ka vulosur me vule te kompanisë vet, e flete te tille mundet te shkruaj ndokush por kërkesa ka qene te prezantohet me dud doganor, faturë blerëse ose librezë qarkullimi për mjetet qe regjistrohen,si rrjedhojë ketë pik nuk e ka plotësuar sipas kërkesës dhe komisioni vlerësues është dashur qe ta vërej gjate vlerësimit.

Eksperti Shqyrtues sqaron se, në ankesin 7 në DT kërkohet:

Makine ngjeshese prej 180-200 kg	1
----------------------------------	---

Eksperti Shqyrtues sqaron se në ofertën e OE të rekomanduarit tek Lista e Makinerive ekzistojnë 2 Makina ngjeshëse:

COMPANY ZILKA COMMERCIAL B.S.R. Rr. "Metohy Krasniq" nr. 135 Njësi Fiskale: B10201944 60000 GJILAN		Neshur Street B.S. Psh. Veshimes Numri fiskal: B11299001 6111 GJILAN		
FATURA Nr. 002 / 2020				
Nr. Rren.	Emri i artikullit	Sasia	Çmimi / €	SHUMË Euro
1	UNKËRË - QARQËZË PËR NGJESHËSË TONË 200 KG.	1	700.00	700.00
Me taksë e Shitësit (VAT) - 0.00 (0%)				
TOTAL:				700.00
Ne Gjilan, Me 15.07.2020				
				

40 Papuqe ngjeshjen e tokes - Wacker (200 kg)

41 Papuqe ngjeshje per kanal - Wacker

Pra, OE i rekomanduari ka të bashkangjitur po ashtu edhe faturën e blerjes shih lartë faturën, ku konsideron se OE i rekomanduari e plotëson kriterin edhe tek pika 13 në Ankesin 7 në DT.

Eksperti Shqyrtues tutje sqaron, OE ankuesi si përfundim ka deklaruar në ankesë se: Komisioni vlerësues ka bere shkelje gjatë vlerësimit duke mos i trajtuar ne mënyre te barabartë te gjithë operatoret ekonomik dhe duke favorizuar operator qe nuk i plotësojnë kushtet minimale e ne anën tjetër duke na shpalle te pa përgjegjshme kompaninë tonë me pretendime qe nuk qëndrojnë, kjo na jep me kuptuar se komisioni vlerësues është i ndikuar dhe ka vendos duke qene nen ndikim dhe me qellim ka favorizuar operatorin e shpallur fitues kundërligjshëm.

Eksperti Shqyrtues si përfundim sqaron se, OE ankuesi është shpallur i eliminuar nga AK pa të drejtë, pasi që i njëjti i plotëson kriteret dhe është i përgjegjshëm, por i pa suksesshëm me çmim më të lartë se sa OE i rekomanduari. Gjersa OE i rekomanduari i plotëson kriteret dhe është i përgjegjshëm dhe i suksesshëm me çmimin më të ulët, meqë rast edhe i rekomanduar për dhënie të kontratës.

Andaj AK gjatë njoftimit të operuesit, ka qenë dashur që OE ankuesin ta njoftoj me Letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm, pasi që është i përgjegjshëm me çmimin më të lartë se sa i rekomanduari.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN
BELEDIYESI



NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: " Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit tretë, pastrimi i lumenjëve dhe largimi i deponive të egra " Numri i aktivitetit të prokurimit: GL 651-20-4015-5-2-1.

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës
1.	"Company Zuka Commerce" Sh.p.k.	143,32 euro
2	Grup i Operatorëve Ekonomik Globi - M.L. SH.P.K.; Mirusha Company Sh.p.k	123,10 euro
3	Grup i Operatorëve Ekonomik Pro & Co Group SH.P.K.; ARLINDI SHPK	61,90 euro
4	COMPANY"BEJTA COMMERCE"SH.A	387,34 euro
5	K.N.T.SH. Teuta - M SH.P.K.	398,40 euro

Komuna e Gjiçanit për " Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit tretë, pastrimi i lumenjëve dhe largimi i deponive të egra " Numri i aktivitetit të prokurimit GL 651-20-4015-5-2-1 Komuna e Gjiçanit shpërblyen me kontratë "Company Zuka Commerce" Sh.p.k. në vlerë prej 143,32 euro.

Data: 02.10.2020

Emri dhe mbiemri i ZPP: Izet Kurteshi

Eksperti Shqyrtues si konkludim, konsideron se ankesa e OE ankuesit lidhur me pretendimet mbi eliminimin e të njëjtit gjenden të bazuara, gjerësa pretendimet lidhur me OE të rekomanduarin gjenden të pa bazuara, dhe si përfundim ankesa e OE ankuesi konsiderohet pjesërisht e aprovuar dhe se vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të mbetet më fuqi.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht dhe se vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Autoriteti Kontraktues me datë 06.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues..

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 13.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbal mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Bejta Commerce" SHA, se me rastin e qasjes në dokumente në prani të zyrtarëve të prokurimit të AK-së, vërtetuar se pretendimet që na janë dhënë nuk qëndrojnë sepse i kemi të vendosur 2 traktorë dhe që të dy janë sipas kërkesës edhe pse kërkesa ka qenë 1 traktor, i kemi të vendosur 4 eskavator dhe që të gjithë janë sipas kërkesës së FDT, i kemi të vendosur 4 Cilindra dhe që të gjithë janë sipas kërkesës së FDT. Të gjitha këto janë të shënuara në procesverbalin e mbajtur nga zyrtarja e prokurimit në qasje në dokumentacion gjithashtu si provë do ja bashkangjesim edhe këtë procesverbal ankesës.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK ka shpallë të eliminuar ankuesin me arsyetimin se komisioni profesional për rzkaminimin dhe vlerësimin e ofertave ka konstatuar se nuk e plotësoni këtë kriter ashtu siç është kërkuar në DT, si dhe në njoftimin për kontratë traktori nuk i plotëson kushtet dhe specifikat e kërkuara, po ashtu disa eskavator ku një prej tyre i mundon edhe një cilindër. Lidhur me këtë konstatim të AK-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimet e OE ankues i gjenë të bazuara me faktin se në ofertën e OE ankues gjenden këto pajisje pasi që ka ofruar dy traktor të cilët përmbushin kriterin, në ofertën e OE ankues gjenden katër eskavator të cilët e

përmbushin kriterin, si dhe në ofertën e OE ankues janë katër cilindër të cilët e përmbushin kërkesën e AK-së. Më tej, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK ka shpallur ankuesin të eliminuar për kriteret e lartpërmendur, ndërsa gjatë shqyrtimit të lëndës dhe verifikimit të ofertës në e-prokurim, rezulton se këto kritere OE ankues i plotëson dhe se është i përgjegjshëm por i pa suksesshëm me çmimin më të lartë.

Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues ka pretendime edhe lidhur me OE të rekomanduarin “Zuka Company” SHPK, i cili pretendon se ky i fundit nuk i plotëson kriteret e AK-së dhe se është i pa përgjegjshëm. Konkretisht, tek kërkesa e makinerisë pika 2. Kamion për pastrimin e rrugëve ka vendosur një kamion me targa 06-895-CT, që nuk ka regjistrim dhe që i ka skaduar në 2018. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se gjatë shqyrtimit të lëndës dhe ofertës së OE të rekomanduarit në e-prokurim, pretendimin e lartpërmendur të OE ankuesit e gjene të pa bazuar me faktin se në ofertën e të rekomanduarit janë të vendosur dy kamion për pastrimin e rrugëve, ashtu siç kërkohet në aneksin 7 në dosje të tenderit. Ndërsa, sa i përket targës 06-895-CT, nuk kemi gjet asnjë librezë me targën e faktuar nga OE ankuesi. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesa e AK-së është kamion për pastrim të rrugëve dy copë, ndërsa në ofertën e OE të rekomanduarit ekzistojnë dhe në librezë shkrimi “Kamion për pastrimin e rrugëve me dy dyer”, ku eksperti ka bashkangjitur librezën në raportin e ekspertizës.

Lidhur me pretendimin e dytë të OE ankues, se OE i rekomanduar ka vendosur një ngarkues që nuk i plotëson kërkesat sepse te kërkesa te pika 9. Ngarkues 10 deri ne 12 ton, ka vendosur një ngarkues që nuk i plotëson kërkesat sepse pesha e tij është 14.5 ton.

Paneli Shqyrtues konform eksperti shqyrtues sa i përket këtij pretendimi, gjatë shqyrtimit të ofertës së OE të rekomanduarit në e-prokurim, ky pretendim nuk gjendet i bazuar me faktin se në kërkesën e AK-së tek aneksi 7 në dosje të tenderit është kërkuar një ngarkues mbi 10 ton. Më tej, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar ka përmbushur kriterin sepse siç shihet kërkohet ngarkues mbi 10 ton, dhe nuk ka limit DERI siç pretendon ankuesi 10 deri në 12 ton.

Lidhur me pretendimin e radhës të OE ankues “Bejta Commerce” SHA, kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, se tek kërkesa te pika 13. makineri ngjeshëse prej 180-200kg, ka vendosur një foto të një makinerie të tillë dhe nuk ka asnjë dokument që e vërteton që makineria është pronë e tij, përveç një flete që e ka shkruar në kompjuter vet dhe e ka vulosur me vulë të kompanisë së vet, e fletë të tillë mundet të shkruaj ndokush por kërkesa ka qenë të prezantohet me dud doganor, faturë blerëse ose librezë qarkullimi për mjetet që regjistrohen, si rrjedhojë ketë pikë nuk e ka plotësuar sipas kërkesës dhe komisioni vlerësues

është dashur që ta vërej gjatë vlerësimit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në aneksin 7 në dosje të tenderit kërkohet një makinë ngjeshëse prej 180-200 kg, kurse në ofertën e OE të rekomanduar tek Lista e Makinerive ekzistojnë 2 Makina ngjeshëse dhe eksperti i ka bashkangjitur faturën Nr.002/2020 në raportin e ekspertizës. Pra, OE i rekomanduar ka të bashkangjitur po ashtu edhe faturën e blerjes, ku konsideron se OE i rekomanduar e plotëson kriterin edhe tek pika 13 në Ankesin 7 në dosje të tenderit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se OE ankues është shpallur i eliminuar nga AK pa të drejtë, pasi që i njëjti i plotëson kriteret dhe është i përgjegjshëm, por i pa suksesshëm me çmim më të lartë se sa OE i rekomanduar. Megjithatë, duke pasur parasysh që OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmim më të lirë dhe i plotëson kriteret, kurse tenderi i OE ankues është me çmim më të shtrenjtë, atëherë mund të konsiderohet se AK ka vepruar drejt konform nenit 60 të LPP-së .

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenkovic



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK KUVENDI KOMUNAL- GJILAN;
- 1x1 OE "Bejta Commerce"SHA- Gjilan;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.